

## Përfshirja e të huajve në Ballkanin Perëndimor – qasja në të drejtat sociale dhe ekonomike (FOSTER)

### Aplikanti kryesor

MYLA – Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas, Maqedonia e Veriut

### Partnerët

Grupi 484, Serbi, Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut (BCHR), Serbi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), Shqipëri, Programi për të drejtat civile në Kosovë (CRP/K), Kosovë, Të drejtat tuaja - Vasa Prava (VP), Bosnjë dhe Hercegovinë, Qendra Ligjore (LC) Mali i Zi, Këshilli Danez për Refugjatët (DRC), Zyra e Serbisë

### Bashkëpunëtorët

Komisioni për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në Maqedoninë e Veriut; Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi; Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë; Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë në Serbi; Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë

### Periudha e zbatimit

1 mars 2023 – 31 gusht 2026

### Sfondi dhe përshkrimi i projektit

Veprimi është zhvilluar nga 7 OShC të bashkuara në Këshillin Ballkanik për Refugjatët dhe Migracionin (BRMC)<sup>1</sup> dhe Këshilli Danez për Refugjatët (DRC) për të trajtuar sfidat e përbashkëta të lidhura me migracionin në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke u përqendruar në të drejtat themelore të njeriut të grupeve të ndryshme të cënueshme të migrantëve dhe të të huajve, veçanërisht në qasjen e tyre në të drejtat sociale dhe ekonomike.

Në raportet e BE-së, situata në vendet e Ballkanit Perëndimor është ende e karakterizuar nga mangësi të theksuara në përbushjen e kriterëve kryesore politike. Rajoni është në fazën e hershme të përgatitjes së lirisë së lëvizjes së punëtorëve dhe qasjes në tregun e punës. Me nismën e Ballkanit të Hapur dhe Procesin e Berlinit, pritet që lëvizjet e migracionit brenda rajonit të intensifikohen. Gjithsesi, megjithëse kornizat institucionale dhe legjislative për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi, janë zhvilluar dhe kryesisht janë të harmonizuara me legjislacionin e BE-së, në praktikë, garantimi i mundësive të barabarta, veçanërisht për të huajt dhe grupet e marginalizuara, mbetet një sfidë.

Veprimi do të forcojë kapacitetet e OShC-ve dhe institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut (IHR) për të kontribuar në politikë-bërjen, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të huajve dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të rajonit të BP-s. OShC-të do të fuqizohen me njohuri dhe aftësi në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve kombëtare dhe rajonale dhe materialeve avokuese për të përmirësuar të drejtat sociale dhe ekonomike të të huajve në pozitë të cënueshme.

### Objektivi i veprimit

*Përforcimi i harmonizimit me parimet e BE-së për të drejtat e njeriut nëpërmjet zhvillimit të politikave gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese si dhe praktikave efektive të përfshirjes për të huajt e cënueshëm, si parakusht për procesin e suksesshëm të përafrimit me BE-në dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Ballkanit Perëndimor.*

### Veprimtari

- Identifikimi i OShC-ve dhe vlerësimi i kapaciteteve të tyre lidhur me ofrimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave.
- Ngritja e kapaciteteve dhe rrjetëzimi i OShC-ve vendore dhe Nismave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në të gjithë BP-në duke u përqendruar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike si dhe në qasjen në shërbime për të huajt në pozita të cënueshme
- Nën-grantimi i deri në 24 projekteve kombëtare dhe 6 rajonale në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore të të huajve dhe mentorimin ndaj OShC-ve
- Veprimtari avokuese për harmonizimin e kornizës ligjore, të politikave dhe praktikës në rajonin e BP

### Grupet e synuara

OSHC-të vendore dhe institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut në vendet e BP

### Përfituesit përfundimtarë

Të huajt në pozita të cënueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor (migrantë të rregullt dhe të parregullt, refugjatë, viktima të krimeve të ndryshme); institucionet dhe organizatat përkatëse qeveritare në vendet e Ballkanit Perëndimor; gjykatat përkatëse në vendet e Ballkanit Perëndimor; media në vendet e Ballkanit Perëndimor; akademia në vendet e BP; qytetarët e Ballkanit Perëndimor

<sup>1</sup> Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas (MYLA), Grupi 484, Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut (BCHR), Programi për të drejtat civile në Kosovë (CRP/K), Vasa Prava Bosnjë dhe Hercegovinë (VP BH) janë anëtarë të rrjetit të Këshillit Ballkanik të Migracionit të Refugjatëve (BRMC)